



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:173603

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734402

KPPP.nr.33/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Eurosig” SH.A. me seli në Prishtinë, rruga “2 korriku” nr.4. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.M.H., kundër debitorit “Trepça” SH.A., me seli në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.B., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.656/21 të datës 22.06.2021, të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datës 24.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.656/21i datës 22.06.2021, i Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,932.00€, (pesëmijë e nëntëqind e tridhjetë e dy euro) sipas Faturës Nr.023256 të datës 15.08.2018.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.656/21 të datës 22.06.2021, i Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli për shumën prej 90,987.80€ (nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë euro) sipas Faturës Nr.027777 të datës 03.09.2019 dhe Faturës Nr. 031553 të datës 21.08.2020.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Eurosig” SH.A. ndaj “Trepça” SH.A., sipas urdhrit P.nr.656/21të datës 22.06.2021, shumën prej 5,932.00€, (pesëmijë e nëntëqind e tridhjetë e dy euro) sipas Faturës Nr.023256 të datës 15.08.2018
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Eurosig” SH.A SH.P.K. ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.656/21të datës 22.06.2021, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Nr.023256 e datës 15.08.2018 në shumën prej 5,932.00€, Faturës Nr.027777 e datës 03.09.2019 në shumën prej 45,993.60€ si dhe Faturës Nr. 031553 e datës 21.08.2020 në shumën prej 44,994.20€, me të cilin ka detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 96,919.80€, në emër të borxhit me kamatë ligjore 8% në vit duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbaresi privat do të zbatoj përmbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit me shitjen e tyre dhe të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, në të cilin ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin për përmbarim me arsyetimin se ende nuk ka arritur afati për pagesë, pasi që kreditori nuk ka caktuar afatin brenda të cilit duhet të bëhet pagesa, andaj ka konsideruar se debitori ka ende afat për kryerjen e obligimeve. Gjykatës i ka propozuar që ta anuloj urdhrin.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe të paargumentuara. Më tej ka theksuar se pretendimi i debitorit se faturat nuk kanë afat pagese nuk qëndron, për faktin se secila faturë ka afatin e caktuar bazuar në kontratën publike kornizë e cila ka kaluar procedurat e prokurimit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përmbarimorë.

Lidhur me këtë çështje gjykata ka caktuar seancën dëgjimore me datë 23.04.2024 në të cilën kanë prezentuar përfaqësuesit e kreditorit dhe debitorit.

Përfaqësuesi i kreditorit ka qëndruar në tërësi pranë propozimit për përmbarim dhe gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit si dhe ka kërkuar shpenzimet e avokatit. Ndërsa pemës parashtrësës së datës 26.04.2024 ka theksuar se debitori për faturën nr. 023256 ka paguar katër këste dhe atë me datë 12.09.2018 shumën prej 10,000.00€, me datë 14.11.2018 shumën prej 10,000.00€, me datë 27.08.2019 shumën prej 6,000.00€ dhe me datë 26.05.2020 shumën prej 15,000.00€ ashtu që nga kjo faturë ka mbetur pa u paguar shuma prej 5,932.00 si dhe dy faturat nr. 027777 dhe nr. 031553 apo shuma prej 96.919.80€.

Përfaqësuesi i debitorit ka qëndruar pranë prapësimit dhe deklarimeve në ankesën e datës 04.03.2022 duke theksuar se propozimit për përbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali i dokumenteve të besueshme apo kopja e vërtetuar siç përcaktohet në nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së, andaj gjykatës i ka propozuar që të anulohet në tërësi urdhëri përbarimor P.nr. 656/2021 i datës 22.06.2021. Parashtresën e kreditorit të datës 26.04.2024 e ka pranuar me datë 14.05.2024, por nuk ka dorëzuar përgjigje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, rekomandimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përbarimor P.nr.656/21 i datës 22.06.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr.023256 e datës 15.08.2018 në shumën prej 5,932.00€, për shkak se kjo faturë nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata shqyrtoi këtë çështje përbarimore në përputhje me nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, nenin 29 të LPP-së i cili përcakton se: *“1. Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyese, po qe se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike; 2. Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm. 11 3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetary”* si dhe nenin 37 të LPP-së, ku përcaktohet se: *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se Fatura Nr.023256 e datës 15.08.2018 nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se e njëjta në gjykatë është deponuar në kopje dhe jo në origjinal apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me dispozita ligjore.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbnim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së dhe të shfuqizojë urdhërin për shumën prej 5,932.00€ pasi që nga fletëpagesat e dorëzuara përmes parashtrësës së datës 26.04.2024 gjykata konstatoi se pagesat kanë qenë për faturën nr. 023256 të datës 15.08.2018, por që e njëjta nuk është dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.656/21 të datës 22.06.2021, sipas Faturës Nr.027777 të datës 03.09.2019 në shumën prej 45,993.60€ dhe sipas Faturës Nr. 031553 të datës 21.08.2020 në shumën prej 44,994.20€, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbnimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr.027777 të datës 03.09.2019 dhe Faturën Nr. 031553 të datës 21.08.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.33/24, datë 24.05.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.